

**Mazars Sh.p.k.**

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**

---

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 20

**Mazars sh.p.k.***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 Dhjetor 2016**

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	45,735,067	40,809,903
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	26,372,629	22,002,290
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	-	1,387,486
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	1,380,868	1,105,432
Shpenzime të shtyra	8	9,299,810	10,326,104
<b>Total Aktive Afatshkurtra</b>		<b>82,788,374</b>	<b>75,631,215</b>
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktive afatgjatë materiale	9	5,449,946	5,755,794
Aktive afatgjatë jomateriale	10	206,306	281,639
<b>Total aktive afatgjatë</b>		<b>5,656,252</b>	<b>6,037,433</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>88,444,626</b>	<b>81,668,648</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	11	1,224,653	1,554,627
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	1,467,824	1,682,551
Detyrime tatimore	13	12,065,230	8,667,623
Të ardhurat e shtyra	14	129,020	538,834
Të tjera detyrime	15	31,834,617	17,639,012
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>46,721,344</b>	<b>30,082,647</b>
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	16	28,493,793	44,416,714
Të tjera detyrime		2,096,065	2,127,840
<b>Total Detyrime afatgjatë</b>		<b>30,589,858</b>	<b>46,544,554</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>77,311,202</b>	<b>76,627,201</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali i nënshkruar	17	100,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		4,931,443	328,847
Fitimi i ushtrimit		6,091,981	4,602,600
<b>Total kapitali aksionar</b>		<b>11,133,424</b>	<b>5,041,447</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>88,444,626</b>	<b>81,668,648</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Mazars sh.p.k.***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	121,353,113	98,856,265
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	(196,839)	(875,050)
<b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>		<b>(20,554,815)</b>	<b>(16,853,218)</b>
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	20	(11,360,750)	(7,568,253)
2) Të tjera shpenzime	21	(9,194,065)	(9,284,965)
<b>Shpenzime të personelit</b>	22	<b>(88,612,096)</b>	<b>(68,902,958)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(84,710,149)	(65,229,540)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetsore		(3,901,947)	(3,673,418)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9/10	(1,360,015)	(1,329,573)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(3,000,000)	(5,015,712)
<b>Të ardhura të tjera</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime financiare</b>	24	<b>332,285</b>	<b>656,258</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime			
1) të ngjashme		(1,766)	5,916
2) Shpenzime të tjera financiare		334,051	650,342
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>7,961,633</b>	<b>6,536,012</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	25	<b>(1,869,652)</b>	<b>(1,933,412)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,869,652)	(1,933,412)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>6,091,981</b>	<b>4,602,600</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>6,091,981</b>	<b>4,602,600</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Mazars sh.p.k.***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014</b>	<b>100,000</b>	<b>10,000</b>	<b>-</b>	<b>328,847</b>	<b>438,847</b>
Fitimi / Humbja e vitit				4,602,600	4,602,600
Lëvizjet përmes kapitalit			328,847	(328,847)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015</b>	<b>100,000</b>	<b>10,000</b>	<b>328,847</b>	<b>4,602,600</b>	<b>5,041,447</b>
Fitimi / Humbja e vitit				6,091,977	6,091,977
Lëvizjet përmes kapitalit			4,602,600	(4,602,600)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016</b>	<b>100,000</b>	<b>10,000</b>	<b>4,931,447</b>	<b>6,091,977</b>	<b>11,133,424</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Mazars sh.p.k më 29 Mars 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.

  
Teit Gjini  
Administrator

  
Bernard Cumashi  
Hartuesi I Pasqyrave Financiare

  
Rr. Emin Duraku - Pali "Binjaket",  
No.5, 1000, Tirana, Albania  
phone : +355 42 27 80 15  
www.mazars.al , info@mazars.al

**Mazars Sh.p.k.***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	6,091,981	4,602,600
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	66,356	9,792
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	202,166	1,552,965
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,360,015	1,329,573
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(2,231,999)	11,200,676
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	2,342,237	5,103,389
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	14,094,294	8,889,948
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>	<b>21,925,050</b>	<b>32,688,943</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(963,309)	(2,258,755)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jomateriale	(15,525)	
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti i investimit</b>	<b>(978,834)</b>	<b>(2,258,755)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i financimit</b>		
Pagesa e huave	(15,620,646)	753,977
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit</b>	<b>(15,620,646)</b>	<b>753,977</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>5,325,570</b>	<b>31,184,165</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	40,809,903	10,285,871
<i>Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(400,406)	(660,133)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>45,735,067</b>	<b>40,809,903</b>
<b>4</b>		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria "Mazars" sh.p.k (ish-Gjini Consulting sh.p.k) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 17 Maj 2003 në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria "Gjini Consulting" sh.p.k u bë anëtar plotësisht i integruar në partnershipin Global të MAZARS që prej datës 1 janar 2015, dhe që prej kësaj date emri i saj është "Mazars" sh.p.k.

Shoqëria është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore me NIPT K32123006W.

Selia e shoqërisë është: Rr."Emin Duraku", Pall. "Binjaket", Nr 5, Kati i I-rë teknik, Ap. 1&2, Tiranë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100 aksione me vlerë nominale 100,000 LEK i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 leke.

Mazars Sh.p.k është një shoqëri shqiptare, e zotëruar nga ortakët:

- Z.Teit Gjini, zotërues i 50 kuotave ose 50% të kapitalit të shoqërisë;
- Znj.Irena Pulo, zotëruese e 5 kuotave ose 5% të kapitalit të shoqërisë;
- Znj.Diana Ylli, zotëruese e 45 kuotave ose 45% të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është Z. Teit Gjini

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është Kryerja e Shërbimeve të auditimit dhe e shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë, të shërbimeve të lidhura, sipas përcaktimit të këtyre shërbimeve të dhëna nga IFAC. Kryerja e Shërbime të kontabilitetit, Shërbimet e mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore, hartimi i pasqyrave financiare etj.

**Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte 29 punonjës (2015: 25 punonjës).**

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe amenduar me urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga SNK për prezantimin e pasqyrave financiare.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/LEK	135.23	137.28
USD/LEK	128.17	125.79
GBP/LEK	157.56	186.59

**3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

*Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e Amortizimit</b>	<b>Norma e Amortizimit</b>
Mobilje për zyrën dhe kantierin	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %
Aktive Afatgjata jomateriale	Lineare	15%

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.4. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

**3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

**3.6. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### **3.8. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

#### **3.9. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### **3.10. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura

#### **3.11. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerre

## 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

## 3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## 4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	45,384,410	40,667,450
Llogari rrjedhëse	45,384,410	40,667,450
Mjete monetare në arkë	350,657	142,453
<b>Totali</b>	<b><u>45,735,067</u></b>	<b><u>40,809,903</u></b>

## 5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Klientë	34,372,629	27,002,290
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(8,000,000)	(5,000,000)
<b>Totali</b>	<b><u>26,372,629</u></b>	<b><u>22,002,290</u></b>

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim për vitin 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Gjendja më 1 Janar	5,000,000	
Rimarrje		
Zhvlerësimi për vitin	3,000,000	5,000,000
<b>Totali</b>	<b><u>8,000,000</u></b>	<b><u>5,000,000</u></b>

## 6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Të Arkëtueshme tregtare nga Mazars group	-	100,957
Të Arkëtueshme të tjera nga Mazars group		1,286,529
<b>Totali</b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>1,387,486</u></b>

**Mazars Sh.p.k.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016***(Vlerat janë në Lek)***7. Të tjera llogari të arkëtueshme afatshkurtra**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Fond Garanci për Zyrat	766,303	777,920
Detyrime Doganore	3,012	3,012
Përfitimë afatshkurta nga sigurimet	208,420	19,834
Te tjera	403,133	304,666
<b>Totali</b>	<b><u>1,380,868</u></b>	<b><u>1,105,432</u></b>

**8. Parapagimet dhe Shpenzime të shtyra**

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	9,299,810	10,326,104
<b>Totali</b>	<b><u>9,299,810</u></b>	<b><u>10,326,104</u></b>

**Mazars Sh.p.k.****Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016***(Vlerat janë në Lek)***9. Aktive Afatgjata Materiale**

	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
<b>Kosto</b>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	3,670,713	1,541,500	1,618,315	6,830,528
Shtesa	1,118,910	980,799	159,046	2,258,755
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>4,789,623</b>	<b>2,522,299</b>	<b>1,777,361</b>	<b>9,089,283</b>
Shtesa	102,382	841,838	19,089	963,309
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>4,892,005</b>	<b>3,364,137</b>	<b>1,796,450</b>	<b>10,052,592</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	(1,203,181)	(487,747)	(402,100)	(2,093,028)
Amortizimi i vitit	(639,377)	(337,012)	(264,072)	(1,240,461)
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>(1,842,558)</b>	<b>(824,759)</b>	<b>(666,172)</b>	<b>(3,333,489)</b>
Amortizimi i vitit	(626,330)	(420,407)	(222,420)	(1,269,157)
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>(2,468,888)</b>	<b>(1,245,166)</b>	<b>(888,592)</b>	<b>(4,602,646)</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	2,467,532	1,053,753	1,216,215	4,737,500
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	2,947,065	1,697,540	1,111,189	5,755,794
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	2,423,117	2,118,971	907,858	5,449,946

## 10. Aktive Afatgjata Materiale

	Programe	Totali
<b>Kosto</b>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	594,073	594,073
Shtesa		-
Pakësime		
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>594,073</b>	<b>594,073</b>
Shtesa	15,525	15,525
Pakësime		-
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>609,598</b>	<b>609,598</b>
<b>Zhvlërësimi i akumuluar</b>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	223,322	223,322
Amortizimi i vitit	89,112	89,112
Pakësime		
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>312,434</b>	<b>312,434</b>
Amortizimi i vitit	90,858	90,858
Pakësime		-
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>403,292</b>	<b>403,292</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	370,751	370,751
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	281,639	281,639
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	206,306	206,306

## 11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Furnitorë vendas	1,171,336	1,518,708
Furnitorë për fatura të pa mbëritura	53,317	35,919
<b>Totali</b>	<b>1,224,653</b>	<b>1,554,627</b>

## 12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Llogari të pagueshme tregtare	1,467,824	1,682,551
<b>Totali</b>	<b>1,467,824</b>	<b>1,682,551</b>



**Mazars Sh.p.k.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lek)

**13. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	9,486,575	5,800,987
TVSH për t'u paguar	1,579,198	1,606,301
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	613,559	497,658
Tatim fitimi	202,166	721,460
Tatim në Burim	183,732	41,217
<b>Totali</b>	<b><u>12,065,230</u></b>	<b><u>8,667,623</u></b>

**14. Të ardhurat e shtyra**

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Parapagime nga klientë	129,020	538,834
<b>Totali</b>	<b><u>129,020</u></b>	<b><u>538,834</u></b>

**15. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjeramë 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Detyrime ndaj personelit	31,461,414	17,367,118
Debitorë & kreditorë të tjerë	373,203	271,894
<b>Totali</b>	<b><u>31,834,617</u></b>	<b><u>17,639,012</u></b>

**16. Llogari afatgjata të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogaritë afatgjatatë pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Finacim Teit Gjini	23,245,363	39,523,394
Finacim Diana Ylli (Golemi)	2,624,215	2,446,660
Finacim Irena Hoxha (Pulo )	2,624,215	2,446,660
<b>Totali</b>	<b><u>28,493,793</u></b>	<b><u>44,416,714</u></b>

## 17. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërise është 100,000 LEK I zotëruar si më poshtë përkatësisht për vitet 2016 dhe 2015:

Aksioneri	Kuotat	31 dhjetor 2016			31 dhjetor 2015			
		Vlera nominale	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	Vlera nominale	%
Teit Gjini	50	1,000	50,000	50%	50	1,000	50,000	50%
Irena Puno	5	1,000	5,000	5%	5	1,000	5,000	5%
Diana Ylli	45	1,000	45,000	45%	45	1,000	45,000	45%
<b>Total</b>	<b>100</b>		<b>100,000</b>	<b>100%</b>	<b>100</b>		<b>100,000</b>	<b>100%</b>

## 18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Auditime	47,932,192	48,968,438
Kontabilitet dhe të tjera	73,420,921	49,887,827
<b>Totali</b>	<b>121,353,113</b>	<b>98,856,265</b>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	121,313,351
Ndryshimi i gjendjes së parapagimeve	409,718
<b>Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH</b>	<b>121,723,069</b>
Shërbime	121,353,113
Të tjera	369,956
<b>Te ardhura te deklaruar ne PASH te cilat jane deklaruar shitje ne FDP</b>	<b>121,723,069</b>
Të ardhurat nga interesat	344
Fitim nga këmbimet valutore	830,488
<b>Total të ardhura të deklaruar FDP e Tatim Ftimit</b>	<b>122,553,901</b>

## 19. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Fitime nga këmbimet valutore	442,346	252,009
Humbje nga këmbimet valutore	(1,009,141)	(1,347,889)
Të ardhura të tjera	369,956	220,830
<b>Totali</b>	<b>(196,839)</b>	<b>(875,050)</b>

## 20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Qera Zyra	3,296,520	3,351,040
Nënkotaktorë	3,029,548	663,967
Royalties dhe shërbime teknike	2,226,083	1,300,789
Shpenzime për përshtatje Zyra	1,178,070	1,136,933
Shpenzime materiale konsumi	960,702	463,361
Kuota antarësimi në Institutin e Ekspertëve	669,827	652,163
<b>Totali</b>	<b>11,360,750</b>	<b>7,568,253</b>

## 21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	2,277,931	2,519,536
Të ndryshme	1,782,201	1,067,673
Shpenzime utilitare dhe mirmbajtje	1,423,298	1,441,999
Shpenzime për pritje	1,200,219	1,153,213
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	848,960	827,478
Trajnime dhe kualifikime dhe rekrutime	506,900	202,364
Prime sigurimi	378,494	536,656
Anëtarësime dhe abonime	291,730	85,405
Komisione bankare	253,073	280,328
Promocione	231,259	907,813
Qera ambjenti	-	262,500
<b>Totali</b>	<b>9,194,065</b>	<b>9,284,965</b>

**22. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për paga	84,660,149	65,229,540
Shpenzime për sigurime shoq e shënd	3,901,947	3,673,418
Shperblime per raste te vecanta	50,000	-
<b>Totali</b>	<b>88,612,096</b>	<b>68,902,958</b>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 29 (2015: 25).

**23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Gjoha dhe penalitete	-	15,712
Provizion për zhvlerësim të të drejtave për arkëtim	3,000,000	5,000,000
<b>Totali</b>	<b>3,000,000</b>	<b>5,015,712</b>

**24. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për interesa	(1,766)	5,916
Humbje nga këmbimet valutore	(54,093)	(126,816)
Të ardhura nga këmbimet valutore	388,144	777,158
<b>Totali</b>	<b>332,285</b>	<b>656,258</b>

## 25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>7,961,633</b>	<b>6,536,012</b>
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	4,502,711	6,353,402
Shpenzime pritje & përcjellje	909,017	968,742
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	-	15,712
Provizion zhvlerësim kërkesa të arkëtueshme	3,000,000	5,000,000
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullt tatimore	593,694	368,948
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>12,464,344</b>	<b>12,889,414</b>
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>1,869,652</b>	<b>1,933,412</b>
<b>Fitimi I Vitit</b>	<b>6,091,981</b>	<b>4,602,600</b>

## 26. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>Bilanci kontabël</b>		
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Finacim Teit Gjini	23,245,363	39,523,394
Finacim Diana Ylli (Golemi)	2,624,215	2,446,660
Finacim Irena Hoxha (Pulo )	2,624,215	2,446,660
Mazars SCRL	1,418,564	1,300,789
Mazars Kft		381,762
Mazars SA	49,260	
<b>Totali</b>	<b>29,961,617</b>	<b>46,099,265</b>
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura:		
Mazars Scrl	-	1,387,486
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>1,387,486</b>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</b>		
Blerje nga palët e lidhura		
Mazars SCRL	2,226,083	1,300,789
Mazars Kft	41,700	
Mazars SA	257,714	387,950
<b>Totali</b>	<b>2,525,497</b>	<b>1,688,739</b>

**27. Angazhime dhe pasiguri**

*Çeshtje gjyqesore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

**28. Ngjarje pas datës së Bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.